**STATISTIKA**

| Informatat për lëndën | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti Filozofik, Departamenti i Sociologjisë |
| **Titulli i lëndës:** | **Statistika** |
| **Niveli i studimit:** | BA, Departamenti i Sociologjisë |
| **Statusi i lëndës:** | Obligative |
| **Viti i studimeve:** | Viti I-rë, semestri 2-të |
| **Numri i orëve në javë:** | 2 + 2 orë |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | 6 ECTS |
| **Mësimdhënësi:** | Prof. Dr. Sejdi Rexhepi |
| **Email-i kontaktues:** | sejdi.rexhepi@uni-pr.edu |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Lënda Statistika, ofron një prezantim hyrës të terminologjisë, koncepteve dhe metodave statistikore në nivelin bazë, me një gamë të gjerë të zbatimit praktik. Shembuj të shumtë të ilustruar shpjegojnë qartë qëllimet kryesore dhe sigurojnë një bazë të mjaftueshme për demonstrimin e koncepteve kryesore, duke ndihmuar kështu studentët të paraqesin, të analizojnë, përpunojnë dhe kuptojnë të dhënat dhe modele te thjeshta statistikore. |
| **Qëllimet e lëndës:** | Të dhënat statistikore janë pjesë e të përditshmërisë sonë, dhe me to takohemi çdo ditë. Andaj njohja e statistikës elementare dhe të kuptuarit dhe interpretimi i numrave statistikor është qenësorë për të kuptuar edhe shkencën politikën dhe materien me të cilën ajo merret.<br>Andaj, qëllimi i lëndës Statistika për Shkenca Sociale është që:<br>• Studentët të fitojnë **njohuri** themelor teorike dhe praktike të mjaftueshme për të kuptuar konceptet, për të shtruar probleme të thjeshta, për të grumbulluar të dhëna, |

| | |
|---|---|
| | për ti përpunuar ato dhe për ti interpretuar rezultatet e fituara.<br>• Studentët të **mësojnë konceptet** themelore të statistikave si zgjidhje për probleme të veçanta.<br>• Studentët të mësojnë si **të adresojnë një problem kërkimor** në mënyrë konceptuale përpara se të provojnë që asaj ti japin zgjidhje përmes formulave statistikore.<br>• Studentët të jenë në gjendje që **të aplikojnë** teknika bazë të statistikës përshkruese dhe analitike në hulumtimet e tyre. |
| **Rezultatet e pritura nga ligjëratat** | Studentët do të jenë në gjendje që:<br>• të **kuptojnë** konceptet statistikore, të shtrojnë në mënyrë të pavarur detyra të ndryshme hulumtuese, të dinë ti sistemojnë të dhënat e grumbulluara, të dinë që ti përpunojnë ato dhe numrat e fituar (rezultatet) të dinë që ti interpretojnë.<br>• të **kuptojnë dhe** të marrin parasysh si të **adresojnë** problemin hulumtues dhe pyetjet hulumtuese para se të njëjtat ti përpunojnë me formula statistikore.<br>• ti kenë **të njohura** konceptet themelore statistikore para se të kërkojnë zgjidhje për një çështje apo problem të veçantë.<br>• **të dinë** se si të adresojnë një problem kërkimor në mënyrë konceptuale përpara se të provojnë që asaj ti japin zgjidhje përmes formulave statistikore<br>• t**ë jenë në gjendje** që të në mënyrë të pavarur të lexojnë dhe të kuptojnë raporte dhe të dhëna statistikore raportet e përditshme të punës dhe jetës shoqërore në përgjithësi. |

| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
|---|---|---|---|
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Punë praktike | - | - | - |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 0.24 min | 10 | 4 |
| Ushtrime  në teren | | | |
| Kollokfiume, seminare | 2.5 | 2 | 5 |
| Detyra të  shtëpisë | 5 | 2 | 10 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 12.5 | 25 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provimi final) | 0.15 | 12 | 3 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 0.45 | 4 | 3 |
| Totali | | | <u>125</u> |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | a).Qasja është e bazuar në pjesëmarrjen aktive të studentëve<br><br>1. Mësimdhënësi shpjegon objektivat e mësimit studentëve përmes ligjëratave,<br>2. Përmes tabelës, projektorit dhe formave tjera vizuale prezantohen teoritë dhe konceptet kryesore<br>3. Mësimi i kombinuar interaktiv do të përdoret<br>4. Konkludime të përbashkëta do të nxirren përmes diskutimit të pyetjeve dhe çështjeve të ngritura.<br><br>b). Aktivitetet Grupore<br>1. Tryeza pune, diskutime grupore, prezantime grupore<br><br>c). Aktivitetet tjera<br>1. Kërkime të pavarura nga studentët<br>2. Prezantimi i rezultateve<br>3. Seminare<br>d). Mjetet e punës: |

| | |
|---|---|
| | Tekste mësimore, artikuj, harta, tabela, projektori, fletat e punës, materiale të përgatitura nga mësimdhënësi, etj. |
| **Metodat e vlerësimit:** | Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë të disa kritereve bazë. Studentët do të kenë dy teste provuese me shkrim gjatë mbajtjes së ligjëratave dhe një test (provimin) përfundimtar.<br>Vlerësimi dhe notimi do të bëhet duke marr parasysh suksesin e treguar në teste dhe provimin final si dhe angazhimin e përgjithshëm.<br>Çdo student ka për obligim që të përgatisë dy detyra të shtëpisë si dhe një punim seminarik të cilat së bashku janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm nga kjo lëndë. Tema e detyrave të shtëpisë si dhe e seminarit duhet të caktohet në bashkëpunim me mësimdhënësin e në pajtim me planin mësimorë nga lënda.<br><br>Nota do të ndërtohet duke marrë për bazë këto kritere:<br>Detyra & aktivitete 10%<br>Detyra & vijueshmëria 10%<br>Testi i parë 20%<br>Testi i dytë 20%<br>Provimi final 40%<br>Gjithsej 100% |
| | |
| **Literatura bazë:** | Literatura bazë:<br>1. **Ligjëratat e përgatitura nga mësimdhënësi.**<br>2. Rahmije Mustafa-Topxhiu, Hyrje në Statistikë, Instituti I Financave të Kosovës, 2016 |

| | |
|---|---|
| **Literatura shtesë:** | **Në gjuhen shqipe:**<br>1. Nuhiu, R. dhe Shala, A. Bazat e Statistikës. 1995, Prishtinë.<br>2. Nevruz Koci, Statistikë për menaxher, Ushtrime, "Guttenberg", Tiran, 2010.<br>3. Milan Papiq, Statistika e aplikuar në MS Excel, The Irwin/Me Graw - Hill Series 2000, përkthim nga kroatishtja, Kolegji Universitar "Victory". Prishtinë, 2007.<br><br>**N**ë **gjuhen angleze**<br>1. Peter Gaderisi, Understanding Political Science Statistics: Observations and Expectations in Political Analysis, 2015.<br>2. Jack A. Levin, James Alan Fox, Elementary Statistics in Social Research: Essentials, 3rd edition, Pearson, 2010.<br>3. Theresa Marchant-Shapiro, Statistics for Political Analysis, Understanding the numbers, CQ Press, 2014.<br>4. Robert A. Hanneman, Augustine J. Kposowa, Mark D. Riddle, Basic Statistics, for Social Research, 1st Edition, Jossey-Bass, 2012.<br>5. Alan Agresti, Statistical Methods for the Social Sciences, Pearson, 5 edition, 2018. |

| **Plani i mësimit:** | |
|---|---|
| **Javët** | **Zhvillimi i ligjëratave** |
| ***Java e parë:*** | **Hyrje në statistikë**<br>Prezantimi i lëndës, Metodat e punës dhe vlerësimit, Rëndësia dhe roli i statistikës, Rëndësia e statistikës për shkencat sociale, Rëndësia e njohjes së koncepteve kryesore para se të përdorim formulat statistikore. |
| ***Java e dytë:*** | **Përdorimi I statistikave në shkencat shoqërore**<br>Cila është natyra e kërkimeve sociale, Pse të testojmë hipotezat? Cilat janë fazat e kërkimeve shoqërore, Përdorimi I serive të numrave për kërkime shoqërore, Cili është funksioni I statistikave? |

| | |
|---|---|
| ***Java e tretë*:** | **Fazat e studimit statistikor**<br>e studimit statistikor, Vrojtimi statistikor, -<br>Vrojtimi i përgjithshëm dhe i pjesshëm, Grupimi statistikor, Analiza statistikore, Faza e publikimit dhe interpretimi |
| ***Java e katërt:*** | **Organizimi i të dhënave**<br>Shpërndarjet e frekuencës së të dhënave nominale, Krahasimi i shpërndarjeve, Përpjesëtimet dhe përqindjet, Shpërndarjet e thjeshta të frekuencës së të dhënave rendore dhe intervale, Shpërndarjet e Frekuencës së Grupuar të të dhënave Intervale |
| ***Java e pestë:*** | **Mostrat dhe Populacioni**<br>Dukuria masive, mostra, njësia statistikore, Variablat kualitative dhe kuantitative, Variablat diskrete dhe të vazhdueshme, Statistika përshkruese dhe analitike.<br>Marrja e mostrave të rastësishme, Gabimet gjatë marrjes së mostrës, Mesatarja e gabimit standard gjatë përzgjedhjes së mostres, Intervalet e besimit të përzgjedhjes. |
| ***Java e gjashtë*:** | **Analiza e tendencës qendrore të t'dhënave**<br><br>Mesatarja aritmetike e thjesht, mesatarja aritmetike e ponderuar, Moda, Mediana, Krahasimi I mesatareve. Cila mesatare e përshkruan tendencën qendrore më së miri? |
| ***Java e shtatë:*** | **Paraqitja grafike**<br>Paraqitja përmes shtyllave të thjeshta, të dyfishta dhe shumëfishta, Diagrami polar, Bar diagramet, Diagrami rrethorë, etj. |
| ***Java e tetë:*** | **Testi I parë** |
| ***Java e nëntë*** | **Treguesit e dispersionit/variacionit**<br>Dispersioni, Treguesit relativ dhe absolut të dispersionit, Gjerësia e variacionit, Devijimi mesatar absolut, Varianca dhe devijimi standard, Treguesit relativ të variacionit, Koeficienti i variacionit. |
| ***Java e dhjetë:*** | **Indekset e numrave**<br>Numrat indeksor, Indeksi i sasisë, Shndërrimi i indekseve bazë në zinxhir dhe e kundërta, Indekset agregate të ponderuara. |

| | |
|---|---|
| ***Java e njëmëdhjetë*** | **Indekset e numrave (2)**<br>Indeksi I Laspeyre-it, Paasche-ut, Edgworth-it, etj., Shndërrimi i të dhënave në indekse, Indeksi bazë dhe zinxhir, Interpretimi i indekseve. |
| ***Java e dymbëdhjetë:*** | **Analiza dinamike e serive kohore**<br>Seritë kohore, Komponenta e trendit, sezonale, ciklike, e rastësishme, e serive kohore, Trendi, Mesatarja rrëshqitëse, Indekset stinore.. |
| ***Java e trembëdhjetë*** | **Analiza e regresionit**<br>Regresioni, Modeli i thjeshtë i regresionit linear, Metoda e katrorëve më të vegjël. |
| ***Java e katërmbëdhjetë:*** | **Analiza e korrelacionit**<br>Treguesit e analizës së korrelacionit, Koeficienti i korrelacionit, Koeficienti i determinacionit. |
| ***Java e pesëmbëdhjetë:*** | **Testi 2** |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes në ligjërata:** |
|---|
| Studentët me qëllim të arritjes së suksesit të lartë në studime duhet që:<br>1. Të vijojnë rregullisht ligjëratat dhe ushtrimet e parapara<br>2. Të marrin pjesë në mënyrë aktive në ligjërata përmes pyetjeve, debateve dhe formave tjera të veprimit interaktiv<br>3. Në marrëveshje me mësimdhënësin të punojnë detyra të shtëpisë<br>4. Të marrin pjesë në testet e ndërmjetme si dhe në testin përfundimtar<br>5. Gjatë kohës së mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, testeve apo provimeve kanë për obligim që t'i nënshtrohen kodit të mirësjelljes (mbajtja e qetësisë në mësim, hyrja me kohë në sallë, lëshimi i sallës me pëlqimin e mësimdhënësit, etj.). |